

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2012

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë*).

DATA	R/REPO njëjavore	R/REPO njëmujore	R/REPO tremujore	R/REPO ditore
05.07.2012	14,610.00		1,870.00	
12.07.2012	16,710.00		1,400.00	
19.07.2012	16,000.00		1,950.00	
23.07.2012				1,600.00
26.07.2012	18,400.00	2,000.00		
02.08.2012	11,200.00	2,000.00		
09.08.2012	16,200.00	2,000.00		
16.08.2012	15,400.00	2,000.00		
20.08.2012				-1,020.00
21.08.2012				-1,200.00
22.08.2012				-1,070.00
23.08.2012	13,200.00	2,000.00		-1,200.00
30.08.2012	15,400.00	2,000.00		
06.09.2012	11,800.00	2,000.00		
13.09.2012	14,800.00	2,000.00		
19.09.2012				1,300.00
20.09.2012	13,600.00	2,000.00		1,300.00
21.09.2012				2,800.00
27.09.2012	12,600.00	3,000.00		

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim dhe tërheqje të likuiditetit.

Sasia totale e likuiditetit të injektuar është luhatur rreth vlerave mesatare të tremujorit të mëparshëm, nga 17.2 miliardë lekë në mesatarisht 17.8 miliardë lekë, në tremujorin e tretë të vitit 2012.

Likuiditeti mesatar i injektuar është rreth 22% më i ulët se 1 vit më parë, kur kjo vlerë ishte 23 mld lekë.

Për injektimin e likuiditetit Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 14.61 miliardë lekë në javë*, shoqëruar, në tre javët e para, me marrëveshje të anasjelltë riblerje me maturim tremujor, dhe me marrëveshje të anasjelltë riblerje me maturim njëmujor për javët në vazhdim.

Duke marr shkas nga riinvestimi më i shpeshtë që karakterizon injektimet

mujore, gjë që lehtëson përdorimin e këtij instrumenti paralelisht me operacionin kryesor të tregut, në fund të muajit korrik marrëveshjet e anasjelltë të riblerjes me maturim tremujor filluan të zëvendësoheshin me marrëveshje të anasjelltë njëmujore, e cila u përdor në dhjetë raste, mesatarisht 2.1 miliardë lekë për ankand*.

Për tërheqjen e likuiditetit të tepërt në datat 20-23 gusht 2012, të cilat përkonin dhe me ditët e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar, u përdor instrumenti marrëveshje riblerje me maturim njëditorë, mesatarisht 1.12 miliardë lekë* për ankand.

Në kah të kundërt, për të kompensuar mungesën e likuiditetit në sistem, në ditët e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës, konkretisht në datën 23 korrik si dhe në 19-21 shtator 2012, u përdor në pesë raste instrumenti marrëveshje e anasjelltë riblerjeje me maturim njëditor, mesatarisht 1.40 miliardë lekë* për ankand.

Në vijim të operacioneve strukturore të tregut të hapur, të zhvilluara në pjesën e parë të vitit nga të cilat rritja neto e portofolit të BSH-së rezultoi 6.01 miliardë lekë*, ashtu si ishte paralajmëruar, gjatë tremujorit të tretë të vitit ka nisur sterilizimi i këtij efekti me maturimet në tregun primar. Ulja e riinvestimit të portofolit

* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012

të BSH-së për tremujorin e tretë ka qenë 1.40 miliardë leke* e përqendruar në bono thesari 3 dhe 6 mujore, ndërkohë që 4.61 miliardë lekë* priten të maturohen në tregun primar gjatë tremujorit të fundit të vitit.


1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012, depozita njëditore u përdor në total në 65 raste, mesatarisht 6.95 miliardë lekë, gati 2.44 miliardë lekë më shumë se në tremujorin e kaluar kur ky instrument është përdorur në 42 raste duke regjistruar një mesatare për rreth 4.51 miliardë lekë.

Instrumenti i kredisë njëditore pati përdorim më të lartë se në tremujorin e kaluar, përdorim ky që u përqendrua në ditët e fundit të periudhës së rezervës së detyruar, kryesisht në datat 20-23 Korrik 2012. Gjatë tremujorit të tretë ky instrument u përdor në 5 raste, mesatarisht 1.08 miliardë lekë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për vitin 2011-2012.


Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2011-2012 (me çmim blerjeje).



2. NDRËHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2012

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Banka e Shqipërisë ka vijuar të ndërhyjë në tregun e brendshëm valutor edhe gjatë tremujorit të tretë, duke blerë valutë sipas vendimit të Komitetit të zbatimit të politikës monetare, për të rritur rezervën valutore gjatë këtij viti me të paktën 10.0 milionë euro. Periudha e favorshme sezonale si dhe kërkesa relativisht të ulëta të klientëve bankarë kanë krijuar hapësirat e nevojshme për blerje më të larta nga Banka e Shqipërisë në krahasim me tremujorin e dytë. Si rezultat i ndërhyrjeve janë blerë gjithsej 5.2 milionë euro, me një kurs mesatar prej 137.36 lekë.



2.2 Veprime me institucione të tjera

Edhe gjatë këtij tremujori kanë vazhduar të lidhen kontratat *swap* në valutë dhe lekë midis Bankës së Shqipërisë (BSH) dhe Ministrisë së Financave (MF), nxitur nga nevoja e menaxhimit të likuiditeteve të MF. Blerjet e valutës së BSH-së prej MF-së gjatë kësaj periudhe qenë 6,195.5 milionë lekë, ndërsa shitjet 6,245.8 milionë lekë (nga të cilat 2,788.7 milionë lekë janë *swap outstanding* që maturoheshin në 5 nëntor 2012).

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 165.5 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA).

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCA VE	6,195.5	6,245.8
TË TJERA (IDA, IBRD)	165.5	